



VENDIM

Nr. 31, Datë 20.02.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
AKSIONET E SË CILËS ZOTËROHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK KESH SH.A. PËR PERIU DHËN
1 PRILL 2017 – 31 DHJETOR 2017.**

Në mbështetje të nenit 16, 19, dhe 47 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neni 10 të VKM 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenin 19 pika 1 gërma “c” të Rregullores për organizimi, funksionimin dhe procedurat e ERE, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e datës 20.02.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a., për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017, të përgatitur nga Drejtoritë teknike,

Konstatohet se :

- ERE në përmbushje të përgjegjësisë që i ngarkon Ligji Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në mënyrë të veçantë referuar nenit 19, gërma “c” paragrafi “iii”, miraton, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifën për veprimtaritë e licensuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.
- KESH sh.a. me shkresën Nr. 162. Prot. datë 11.01.2017 ka kërkuar rishikimin e tarifës, që të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen me BERZH pas miratimit të Ligjit Nr. 125/2016 “Për

Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë së Huasë me BERZH për “Planin e Ristrukturimit të KESH”.

- KESH sh.a. ende nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim të saj për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 Prill 2017-31 Dhjetor 2017 në të cilin të parashtrijë me shifra, argumenta dhe analizë ekonomike nevojën për të ardhura të mjaftueshme për veprimtarinë normale dhe arritjen e piksynimeve të saj.
- Me qëllim që të përcaktojë sa më drejt çmimet e shitjes së energjisë elektrike tek klientët fundorë, ERE duhet t’i referohet kostove reale për të gjithë aktivitetet e rregulluara, përfshirë këtu edhe atë të prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria OSHEE sh.a. në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017 nuk ka kërkuar ndryshim të çmimeve për klientët fundorë por rialokim të kostove për nivele tensioni.
- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.01.2017 MEI shprehet se *“Për të përmbyllur me sukses këtë proces, vlerësojmë se është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.